

VENDIM
Nr.1718, datë 24.12.2008

PËR PROCEDURAT E TRANSFORMIMIT TË KLUBEVE SPORTIVE NË SHOQËRI
AKSIONARE DHE PËR KRITERET E PËRCAKTIMIT TË KAPITALIT THEMELTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 19 të ligjit nr.9376, datë 21.4.2005 “Për sportin”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Klubet sportive, që do të transferohen në shoqëri aksionare, do të funksionojnë në bazë të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

2. Procedura e transformimit të tyre fillon me daljen e urdhrit të titullarit të institucionit, në varësi administrative të të cilit është klubi sportiv.

3. Përcaktimi i kapitalit themeltar të këtyre shoqërive, që do të krijohen nga transformimi i klubit sportiv, bëhet në bazë të:

a) bilancit të vitit ushtrimor financiar, pararendës;

b) emrit të klubit, të logos së tij dhe të vlerës, që do të jetë deri në masën 30 për qind të vlerës së kapitalit themeltar. Kjo vlerë përcaktohet nga viti i krijimit të klubit, trofetë e arritura, pjesëmarrja në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare.

4. Përcaktimi i kapitalit të këtyre shoqërive bëhet nga një komision i ngritur pranë çdo klubi, me urdhër të titullarit të tij.

5. Klubi sportiv, i transformuar në shoqëri aksionare, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e ish-klubit sportiv, në bazë të bilancit financiar, në çastin e transformimit.

6. Vlera kontabël e mbetur e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara aktuale rivlerësohet, sipas kriterëve të caktuara në vendimin nr.794, datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe për procedurën e shitjes”.

7. Elementet e pasurisë, pa vlerë përdorimi ose të zhvlerësuara, të trajtohen për t’u nxjerrë jashtë përdorimit ose për ulje vlere, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, në fuqi. Ulja e vlerës të kryhet nga komisioni i vlerësimit, me pjesëmarrjen e dy a më shumë ekspertëve të fushave përkatëse, në varësi nga natyra e elementeve të pasurisë.

8. Bilanci i çeljes së shoqërisë aksionare, të krijuar nga transformimi i klubit sportiv është bilanci i reformuar. Ky bilanc verifikohet edhe vërtetohet nga një ekspert kontabël, i autorizuar, i emëruar nga organi, që ka në varësi këtë klub.

9. Ngarkohen Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të nxjerrin udhëzimin përkatës për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit të vlerësimit e të ekspertit kontabël të autorizuar, si dhe për përcaktimin e mënyrës së vlerësimit të aseteve, logos dhe kapitalit.

10. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha